

"KASTRATI" Sh.A

SHOQERI ANONIME, KAPITALI THEMELTAR
BANKAR 300.000. USD dhe 35.000.000 lek
Ne NATYRE 430.00 USD
SELIA L.14 Rr."Tirana" Shkozet
DURRES - ALBANIA
Tel. 052 64453 Fax. 052 64553

AKT THEMELIMI

PER KRIJIMIN E SHOQERISE ANONIME "KASTRATI" Sh.A. DURRES

Ne qytetin e Durresit, sot me daten 30 Prill 2002 eshte bere ky Akt THEMELIMI per krijimin e Shoqerise Anonime vendase, me emrin "KASTRATI" Sh.A. Durres - Albania nga une shtetasi shqiptar :
I.SHEFQET KASTRATI, atesia Jonuz, amesia Lije, i datelindjes 05.06.1961, lindur ne Kukës, shtetas shqiptar dhe banues ne L.1.Rr." Currilave " Durres **Tel. Celular 0382020768**

Neni 1

Shoqeria ANONIME vendase dhe me Aksioner te vetem themelues ka Emertimin e vet "KASTRATI" Sh.A. Durres-Albania, emertim i cili do te jete i stampuar dhe ne vulen e saj dhe me te cilin do te paraqitet ne çdo dokumentacion dhe ne mardheniet me te tretet.
Ne te gjitha aktet dhe dokumentat qe do te nxjerr Shoqeria, ky emertim i saj do te shoqerohet duke u shenuar ne te dhe Shuma e Kapitalit Themeltar dhe Selia Qendrore.

Neni 2

Aktivitetin e saj Shoqeria ANONIME "KASTRATI" Sh.A. e shtrin ne te gjithë juridiksionin territorial te shtetit shqiptar si dhe jashte shtetit.
SELIA Qendrore e Shoqerise doe te jete ne adresen : L.14, Rr."Tirana" Shkozet Durres - ALBANIA,
Tel. 052 64453 Fax. 052 64553

Neni 3

Me Vendim te Keshillit MBIKQYRES, mund te çelen, transferohen ose mbyllin (ne rast se jane çelur) DEGE e FILIALE si brenda vendit dhe jashte shtetit, me kusht qe ky VENDIM te miratohet nga Mbledhja me e afert e Asamblese se Aksionereve.

Neni 4

Shoqeria ANONIME me Aksioner te vetem themelues "KASTRATI" Sh.A. shte Person Juridik Shqiptar dhe aktivitetin e saj tregetar e bazon ne Legjislacionin vendas dhe kryesisht :
* Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise, miratuar me Ligjin Nr.8417 dt.21.10.1998.
* Ne Ligjin Nr.7632 date 04.11.1992 " Per Dispozitat qe rregullojne Pjesen e Pare te Kodit Tregtar "
* Ne Ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite TREGTARE "
* Ne Ligjin Nr.7667 date 28.01.1993 " Per Rrgjistrin Tregtar "
* Ne Ligjin Nr.7764 date 02.11.1993 " Per Investimet e HUAJA "
* Ne Ligjin Nr.8450 dt.24.02.1999 " Per PERPUNIMIN, Transportin dhe Tregetin e NAFTES, GAZIT e te nenprodukteve te tyre.


* Ne Vendimin e Keshillit te MINISTRAVE Nr.129 date 18.03.1999.
* Ne Kodin CIVIL, Doganor, Legjislacionn Tatimor, Fiskal, Bankar, ate te Komunitetit European si dhe ne Aktin e Themelimit dhe STATUTIN e saj.

Neni 5

Personalitetin JURIDIK, Shoqeria e fiton mbi bazen e Vendimit te Gjykates se rrethit Gjyqesor TIRANE dhe rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar te asaj Gjykate, ndersa ushtrimin e veprimtarise Tregtare te saj e fillon menjehere pas marrjes se Licences dhe Certifikates NIPT ne Organin Tatimor si dhe te AUTORIZIMIT, LEJES se Tregtimit te dhene nga ana e Organit kompetent shteteror.

Neni 6

KOHEZGJATJA e ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise "ANONIME" eshte per nje AFAT 30 Vjet, duke filluar ky afat nga data 30.04.2002 deri me daten 30.04.2032.
Ky AFAT mund te zgjatet ose ndryshoj me VENDIM te Mbledhjes se Asamblese se Jashtezakoneshm Shoqerise mbi bazen e VENDIMIT me 3/4 e votave te shumices se Aksionereve, sipas rregullave te parashikuara ne Kohezgjatja e Shoqerise ANONIME mbaron dhe para ketij AFATI dhe ne keto raste :



02.

- a) Kur Shoqeria ANONIME pushon veprimtarin e saj mbi bazen e VENDIMIT te Mbledhjes se Asamblese
- b) Sipas rasteve te tjera te parashikuara dhe lejuara nga dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 7

Kapitali Themeltar i Shoqerise ANONIME "KASTRATI" Sh.A. dhe pa OFERTE PUBLIKE caktohet dhe perbehet nga kapital ne likuiditet (Bankar) ne shumen 300.000.USD dhe ne natyre 430.000 USD

Kapitali themeltar eshte formuar dhe nenshkruar nga AKSIONERI i vetem themelues i Shoqerise "Kastrati" Sh.A. Z.SHEFQET JONUZ KASTRATI.

Kapitali themeltar ne shumen 300.000 USD dhe 35.000 000 leke ne likuiditet dhe ai ne natyre ne shumen valute 430.000 USD ndahet ne AKSIONE me vlere nominative 1000 Lek /1Aksion gjithsejt 140.850 Aksione,ku nje Aksion pervec vleres nominative ne lek ka dhe vleren e 1 VOTE.

KAPITALI themeltar,eshte kontribut financiar dhe ekonomik i formuar dhe nenshkruar nga AKSIONERI i vetem themelues i Shoqerise "KASTRATI" Sh.A. Z.SHEFQET JONUZ KASTRATI,i cili eshte zoterues ne masen 100% te Kapitalit themeltar dhe zoterues i 140.850 votave me te drejte vendimore

Neni 8

Mbledhja e ASAMBLESE se Jashtezakoneshme te Aksionereve zoterues te AKSIONEVE merr vendim per ritjen dhe zvogelimin e KAPITALIT te saj dhe ky Vendim eshte i VLEFSHEM kur ne kete Mbledhje marrin pjese Aksioneret qe zoterojne 50%+1 te Vleres se Pergjithshme te Aksioneve dhe kur per nje gje te tille votojne 3/4 e Aksionereve te pranishem ose te perfaqesuar me PROKURE dhe qe kane te drejten e votes vendimore.

Neni 9

Shoqeria ANONIME me Aksioner te vetem themelues "KASTRATI" Sh.A. ka per OBJEKT zhvillimin e veprimtarise tregtare ne keto drejtime :

- 1.Krijimin,instalimin dhe venien ne SHFRYTEZIM sipas kushteve teknike te te gjitha paisjeve impiante stacioneve,reperteve dhe linjave per ushtrimin e TREGETIMIT te HIDROKARBUREVE brenda vendit dhe jashte shtetit si vetem dhe ne bashkepunim e kooperim me Shoqeri te tjera Tregtare, Persona juridik vendas apo te Huaj.
- 2.IMPORT EKSPORTIN dhe Tregetin me SHUMICE te NAFTES,GAZIT e NEPRODUKTEVE te tyre te vajrave lubrifikante etj si dhe kryerjen e Transportit si brenda vendit dhe ate NDERKOMBETAR te tyre me mjetet e veta te Transportit tokesor e atij detar ose atyre te te treteve.
- 3.IMPORT EKSPORTIN dhe tregetin me shumice e pakice te Teknologjise dhe pjeseve te kembimit te nevojshme per ushtrimin e veprimtarise HIDROKARBURE duke perfshire dhe blerjen me qellim shitje jo vetem te tyre por edhe te automjeteve te transportit hidrokarbur,te kokave dhe cisternave bote per to dhe per depozita stacionere te bombulave me ose pa mbushje gazi si dhe dhenien e asistences teknike per venien ne shfrytezim dhe kryerjen e çdo servisi teknik per to,si brenda vendit dhe jashte shtetit.
- 4.Ndertimin dhe venien ne perdorim per vehte dhe per te tretet te Depove HIDROKARBURE,rezervuareve te linjave dhe pikave te shitjes se tyre me shumice e pakice sipas projektit perkates teknologjik te miratuar nga Zyra e Urbanistikes,organet e Mbrojtjes se Mjedisit dhe te MKZ si dhe vetem kur jane te paisura me CERTIFIKATEN e Kalibrimit si te rezervuareve Stacionere dhe te aparateve te shitjes se karburanteve dhe pasi te jete marre dhe LEJA e Inspektoriatit Shteteror te NAFTES,GAZIT e nenprodukteve te tyre.
- 5.IMPORT EKSPORTIN dhe tregetin me shumice e pakice te produkteve e artikujve industriale, bujqesore makinerive e teknologjive per ndertim dhe celjen e pikave te shitjes per artikujt e mesipermbre brenda e jashte vendit.....
6. Ndertimin e çdo lloj godine,nje ose shumekateshe sikurse jane Pallatet e Banimit,Qendra Biznesi,Hotele Bar Restorante,magazina,parkingje ,te komplekseve te ndryshme turistike ne zona malore e bregdetare te depove stacionere per karburante e nenprodukteve te tyre dhe kryerje te rikonstruksioneve te tyre..
- 7.Ngritjen dhe venien ne shfrytezim te POLIGONEVE te ndertimit per prodhimin e materialeve inerte te betoneve,penobetoneve dhe te çdo materiali ndertimor parafabrikat,ndertime te Impianteve te Pastrimit te mbeturinave civile dhe industriale,ato per ngritjen dhe restaurimin e rrjetit bonifikues te vaditjes dhe kullimit te tokave,punime dhe kanalizime pr rrjetet e jashtme dhe te brendeshme te UJESJELLSEVE te qendrave te banimit ne qytet e fshat dhe te çdo rrjeti tjetër te sietmit hidrik,prodhim guri per skolierat ne ndertimet portuale dhe Aeroportuale,punime çimentimi dhe te injektive detare,shtirje kabllosh e tubacionesh nenujore,ndertimin e URAVE, te rrugeve dhe te autostradave te komunikacionit urban dhe interurban,asfaltimin e tyre,kryerjen e veprave te artit ,te mirembajtjes dhe permiresimit te tyre ne perputhje me infrastrukturen bashkekohore,si brenda vendit dhe jashte shtetit.
8. CELJEN dhe ushtrimin e aktivitetit te AGJENSIVE Turistike,Doganore dhe Spedicionere te sherbimit social privat me ane te ngritjes,çeljes dhe funksionimit te Hoteleve,Bar-restoranteve,Qendrave te Bisnezit ,te qendrave

03.

dhe pikave te turizmit brenda dhe jashte vendit,si vetem dhe ne kooperim me kompani turistike te huaja, si dhe te Transportit PASAGJER dhe mallrave te çdo lloji me mjetet e veta te Komunikacionit Tokesor, Detar (Arije, Tragete) si dhe ate AJROR civil, me Persona juridik vendas apo te huaj, krijimin e Shoqerive dhe Agjensive te perbashkta te transportit pasagjer nderkombetar me to etj.

9. Celjen dhe funksionimin e nje Zyre PROJEKTIMI dhe zbatimi si per vehte dhe per dhenien e Asitences teknike te Supervisionit ,te kolaudimit dhe te ekspertizes ndertimore te licensuar per nevojat e interesat e te treteve qe ushtrojne aktivitet ndertimor si brenda dhe jashte shtetit.

10. Kooperimin dhe bashkepunimin me Shoqeri Tregtare vendase apo te huaj, me qellim ushtrimi dhe zgjerimi te Aktivitetit te Shoqerise Anonme sipas objektit dhe qellimeve te veprimtarise tregtare per te cilen ajo krijohet etj.....

Neni 10

ORGANET DREJTUESE te Shoqerise ANONIME " KASTRATI" Sh.A. Durres-Albania jane :

1. ASAMBLEJA E AKSIONEREVE (E Jashtezakoneshme dhe e Zakoneshme).

2. KESHILLI MBIKQYRES.

3. DREJTORIA.

Ne mbledhjen themeluese te Asamblese, Ortaku i i vetem dhe zoterues i te gjithe Aksioneve, te Kapitalit themeltar te Shoqerise, vendosi me 100% te votave "Pro" ne detyren e **Ekspertit KONTABEL** te Autorizuar te **Z.HYSEN BEGTASH BEKA**, i datelindjes 06.10.1953, paisur me **LICENSE Nr.098 date 13.12.2000** banues ne L.4 Rr. Skenderbej" P.1046 Durres

Neni 11

Te DREJTAT dhe DETYRAT e organeve DREJTUESE te Shoqerise Anonime, ne menyre te specifikuar jane ato te percaktuara ne STATUTIN e saj, i cili eshte pjese perberese e ketij AKTI THEMELIMI te Shoqerise.

Neni 12

Shoqeria ANONIME " KASTRATI" Sh.A. çel Llogari BANKARE ne lek vendi dhe ne çdo lloj valute te huaj, ne Banka Vendase ose te huaja private ose shtetore, me qellim per te kryer veprimet e nevojshme per ushtrimin dhe perballimin financiar te aktivitetit te saj.

Ortaku Aksionere themelues, depoziton firmen e tij ne BANKAT ku eshte çeluar Llogaria e Shoqerise dhe TERHEQJA e pjeseve te tij per nevojat e Shoqerise, behet vetem ateher kur CEKU BANKAR eshte nenshkruar nga ana e tij ose dhe personi i autorizuar prej tij me Prokure te Posaçme per çdo rast ,ndersa TRANSFERIMI i plote apo i pjeseshem i KAPITALIT themeltar behet kur vertetohet me akt NOTERIAL

Shoqeria dhe te tretet duhet te respektojne keto TRANSFERIME sapo tu behen te ditura.

Neni 13

Aktiviteti Ekonomiko financiar i Shoqerise ANONIME, ndahet ne periudha te cilat zgjasin 12 Muaj, kohe e cila si rregull fillon nga data 01 Janar deri me daten 31 Dhjetor te çdo viti Kalendarik, me perjashtim te periudhes se pare e cila fillon DATEN e Themelimit dhe perfundon me daten 31.12.2001.

Neni 14

Shoqeria do te mbaj nje KONTABILITET te rregullt per administrimin e Pasurise dhe gjithe veprimtarine ekonomiko financiare te saj, ne pajtim me kerkesat e Ligjit " Per Kontabilitetin"

BILANCI Financiar i Shoqerise nxirret mbi bazen e RAPORTIT me shkrim te EKSPERTIT Kontabel te Autorizuar dhe te atij te paraqitura nga DREJTORI i Pergjithshem i saj, brenda dates 31 JANAR te vitit pasardhes dhe brenda 3-Mujorit te l-re te vitit pasardhes.

FITIMI NETO (Dividenti) i Shoqerise ANONIME per llogaritet pasi nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar te jene zbritur HUMBJET e nevojshme te vitit meparshem, vlera e SHLYERJES se plote te DETYRIMEVE Taksuale Tatimore apo Fiskale e çdo lloj detyrimi tjetër i Shoqerise ndaj te TRETEVE si dhe lenien menjane te nje shume te pakten 1/20 te fitimit te rezervuar, e cila destinohet per formimin e nje FONDI rezerve te quajtur "Rezerva e domodoshme"

Neni 15

Shoqeria ANONIME " KASTRATI" Sh.A. mbaron si Person JURIDIK ne keto raste :

1. Me plotesimin e afatit 30 vjeçar per te cilin ajo eshte krijuar.

2. Me VENDIM te Mbledhjes se Asamblese se Jashtezakoneshme te Aksionereve e saj, sipas kushteve ligjore te ushtrimit te kesaj te drejte VENDIMORE.

3. Kur vertetohet nje nga rastet e parashikuara ne Ligjin " Per FALIMENTIMIN" e Shoqerive Aksionere.
Neni 16

Me Mbarimin Person Juridik, Shoqeria kalon ne LIKUIDIM.
Vendimi i Likuidimit te Shoqerise, i marre mbi bazen e Mbledhjes se Asamblese se Jashtezakoneshme te Aksionereve te Shoqerise apo ne LIGJ, u behet i njohur te gjitha AKSIONEREVE, zoterues te aksioneve te Shoqerise nepermjet PUBLIKIMIT te ketij VENDIMI me mjetet e INFORMIMIT PUBLIK dhe duke respektuar te gjitha procedurat ligjore.
Te ARDHURAT e arketuara nga LIKUIDIMI i Shoqerise, pas shlyerjes se cdo detyrimi ndahen ne mes Aksionereve sipas vleres se Kontributit te sejcilit ne formimin e Kapitalit Themeltar.

Neni 17

Ne Mbledhjen e pare te Asamblese se Jashtezakoneshme te Shoqerise Anonime "KASTRATI" Sh.A. me votim unanimit dhe 100% te votave "Pro", ajo vendosi ZGJEDHJEN e Organeve drejtuese te saj dhe konkretisht :

A. KESHILLI MBIKQYRES, te perbere nga tre veta dhe me keto funksione perkatese :

1. Z. Nuhi Xhaferr KOLDASHI, datelindja 01.06 1959, profesioni JURIST me detyren **KRYETAR** i Keshillit MBIKQYRES.

2. Z. Shefit Jonuz KASTRATI, i vit lindjes 1970, me detyren **N/KRYETAR** i Keshillit MBIKQYRES.

3. Z. Bibil Jonuz KASTRATI, i vitlindjes 1976 me detyren **ANETAR** i Keshillit MBIKQYRES, qe te gjitha persona fizik jashte Ortakerise dhe pa kontribut Kapitali Themeltar ne krijimin e Shoqerise Anonime.

B. DREJTORIA e perbere nga 1 person.

Bazuar ne nenin 96/2 i Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerit Tregtare" jashte ortakerise dhe pa kontribut Kapitalit Themeltar ne krijimin e Shoqerise, Mbledhja e pare e Asamblese se Jashtezakoshme Shoqerise me votim 100% te Ortakut te vetem zoterues i te gjitha vleres se Aksioneve qe perbejne kapitalin themeltar te saj, cakton me detyren e **DREJTORIT te Pergjithshem** te Shoqerise Anonime " KASTRATI" Sh.A. dhe per nje peridhe kohe 5 vjet shtetasin shqiptar :

I. Z. GANI NEBI KASTRATI i datelindjes 15.11.1952, lindur ne Kukes dhe banues ne L. I Durres.

Neni 18

Ky Akt THEMELIMI miratohet unanimit, me 100% te votave Pro si ne parim dhe nen per nen nga ana e Ortakut te vetem Themelues dhe zoterues i 100% te Kapitalit themeltar dhe vleres se aksioneve, shtetasi shqiptar **Z. SHEFQET JONUZ KASTRATI**, i datelindjes 05.06.1961, i cili ne mardheniet me te tretet, si brenda dhe jashte vendit do te njihet dhe me cilesin e **PRESIDENTIT** te Shoqerise Anonime "KASTRATI" Sh.A. Durres-ALBANIA.

Neni 19

Cdo mosmarrveshje, ne ushtrimin e veprimtarise tregtare te Shoqerise si rregull duhet te zgjidhet ne mirekuptim ne te kunderten ajo mund te behet objekt i Konfliktit Civil para Gjykates se rrethit Gjyqesor Durres.

Neni 20

Ky AKT Themelimi per krijimin e Shoqerise Anonime "KASTRATI" Sh.A. Durres-Albania u redaktua ne 5 ekzemplare ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera te njejta juridike dhe nenshkruhet pa vrejte nga une Ortaku dhe Aksioneri i vetem Themelues i Shoqerise, duke vene emrin, mbiemrin dhe firmen origjinale, autenticiteti i te cilave eshte legalizuar dhe nga NOTERI.

ORTAKU DHE AKSIONERI VETEM THEMELUES DHE PJESMARRES

Ne Mbledhjen e PARE te Asamblese se Jashtezakoneshme te
te SHOQERISE ANONIME "KASTRATI" Sh.A. Durres-Albania
Shtetasi shqiptar

SHEFQET JONUZ KASTRATI

Shefqet Jonuz Kastrati

